



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPKI	Nr. Prot. 06-01/3105/22
Dep. DPKI	Br. Prot. 06-01/3105/22
Nr. i faq. 03	Data 28-07-2022
Broj stranica 03	Datum 28-07-2022
Nr. pages 03	Date 28-07-2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1, nenit 5 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 21.07.2022, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr.AKK-DPKI-06-2599/22, për zyrtarin e lartë publik z.Milazim Salijaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit, përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të mundshëm interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z.Milazim Salijaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka iniciuar procedurën për trajtimin e rastit të mundshëm të konfliktit të interesit, sipas të cilit z.Milazim Salijaj, duke qenë zyrtarë i lartë publik, respektivisht, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, njëkohësisht mbante edhe funksionin e personit të autorizuar në biznesin privat më emër “N.SH.GjeoProjekt”.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka identifikuar rastin, sipas procedurës ka kërkuar informata nga ARBK-ë (Agjencia Për Regjistrimin e Bizneseve), e ku pastaj është konfirmuar se zyrtari Milazim Salijaj, figuron të jetë pronar edhe person i autorizuar në biznesin privat me emër “N.SH.GjeoProjekt”.

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare nr. AKK-DPKI-06-02/2083/22 për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtari i lartë z.Milazim Salijaj, ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, për tu njoftuar dhe për të marr informacion për situatën e konfliktit të interesit, e ku pastaj më kërkesën e tij është mbajtur edhe një takim informuese në zyrat e AKK-së, me këtë rast zyrtaret e AKK-së e kanë njoftuar atë se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksiononin e zyrtarit të lartë publik, dhe njëkohësisht të ushtroj edhe funksion drejtues, respektivisht, menaxhues në biznesin privat, sepse kjo është e ndaluar me neni 13 (paragrafi 1) dhe 15.2 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilën thuhet:

1. *Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.*

2. *Zyrtari i lartë, pronari i aksioneve, gjegjësisht pjesës së kapitalit në një ndërmarrje, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet t'i transferojë të drejtat e administrimit ose menaxhimit, apo drejtimin të ndërmarrjes tek ndonjë person i besuar.*

Ndërsa me nenin 19 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. *Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:*

1.1. *transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];*

1.3. *jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;*

1.4. *dorëhiqet nga funksioni publik.*

Gjatë takimit të mbajtur me zyrtarin Milazim Salijaj, të quajtur ndryshe edhe si ballafaqim i fakteve, zyrtari i lartë, ka deklaruar se pasi që është zgjedhur deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka njoftuar me shkrim Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), se për shkak të zgjedhjes në funksionin e Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e me qëllim të shmangies së Konfliktit të Interesit, nuk do të zhvillojmë aktivitetin e biznesit që nga data 19.04.2021, në afat të pa caktuar.

Ndërsa sa i përket ndryshimeve si person i autorizuar në biznesin privat, nuk ka pasur njohuri që duhet ta bej këtë ndryshim edhe në ARBK, duke aluduar se biznesi në fjalë nuk ka zhvilluar

aktivitet, por është zotuar se do të marr veprime të menjëhershme që të heq dorë nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat me emër “N.S.H.GjcoProjekt”.


Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar informacionin zyrtar (DPKI-06-02/2920/22), në bazë të së cilit dëshmohet se zyrtari i lartë Milazim Salijaj, ka ndërmarr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni drejtues në biznesin privat.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë Milazim Salijaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës është shmangur gjendja e konfliktit të interesit respektivisht papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L.-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit